



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA ADMINISTRATIVE
Su-01.nr.0102-33 / 2020
29.12.2020
Shkup

Kryetari i Gjykatës Administrative, në përputhje me nenet 88 dhe 92 të Ligjit të Gjykatave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006; nr. 35/2008, nr. 150/2010 dhe nr. 96 / 19), lidhur me nenin 7 paragrafi 1 pika 4 e Rregullores së gjykatës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 66/2013 dhe nr. 114/2014), pas seancës së mbajtur të gjykatësve, më 29.12.2020, miratoi:

PROGRAM
PËR PUNËN E GJYKATËS ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2021

Me këtë program caktohen punët dhe detyrat nga fushëveprimi i Gjykatës Administrative, e sidomos lloji dhe numri i lëndëve ndaj të cilave Gjykata vepron, punët dhe detyrat lidhur me monitorimin dhe hulumtimin e problemeve që dalin nga praktika gjyqësore, e që janë në interes të zbatimit të drejtë dhe të vetëm të ligjeve, etj.

Nëpërmjet caktimit të punëve dhe detyrave që janë në kompetencë të kësaj gjykate, në kryerjen e funksionit gjyqësor të përcaktuar me Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, sigurohet zbatimi i së drejtës dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Qëllimet dhe funksionet e përcaktuara me këtë program, përfshijnë:

1. Zgjidhjen në kohë dhe në mënyrë cilësore të lëndëve që janë nën kompetencë të Gjykatës;
2. Mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;
3. Zbatimin e paanshëm të së drejtës pavarësisht pozitës dhe cilësisë së palëve;
4. Sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve që çdo person të jetojë i sigurt, në kuadër të zbatimit të së drejtës;
5. Përgatitjen e analizave, informacioneve, udhëzimeve etj., të cilat do të ndihmojnë në zbatimin e duhur të së drejtës;
6. Takime dhe këshillime, të organizuara nga Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, në lidhje me edukimin e gjykatësve dhe nëpunësve gjyqësorë, nga Shoqata e Gjykatësve, si dhe nga organet dhe organizatat e tjera.

Në kohën e përgatitjes së Programit të punës për vitin 2021, në Gjykatën Themelore në Shkup janë plotësuar gjithsej 32 vende gjyqësore,

përfshi edhe kryetarin e gjykatës, nga gjithsej 33 vende gjyqësore të parashikuara, përfshi edhe kryetarin e gjykatës, në përputhje me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, ndërsa njërit prej gjykatësve i pushon funksioni gjykatës në Gjykatën Administrative, për shkak se i njëjti është zgjedhur Kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative.

Përfundimisht me ditën e miratimit të këtij Programi, në Gjykatën Administrative janë punësuar: 61 nëpunës gjyqësorë, 4 (katër) pjesëtarë të policisë gjyqësore dhe 2 punonjës, të cilët kryejnë punë teknike. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2020, u zhvillua procedurë për punësimin e 11 nëpunësve gjyqësorë me kohë të caktuar, përfundimisht më 31 dhjetor, 2020.

Gjatë muajit janar të vitit 2020, në Gjykatën Administrative, një nëpunësi të lartë gjyqësor iu ndërpre marrëdhënia e punës në Gjykatën Administrative, ndërsa në të njëjtin muaj, me procedurë për punësim nëpërmjet shpalljes publike, Gjykata Administrative realizoi punësimin e një nëpunësi - udhëheqës gjyqësor, me titull udhëheqës i shërbimit profesional juridik.

Në fillim të shkurtit 2020, Gjykata Administrative, në procedurë për punësim, pa shpallje publike, nëpërmjet marrjes së përhershme, realizoi punësimin e 2 (dy) nëpunësve gjyqësorë profesionalë edhe atë dy bashkëpunëtorë të rinj gjyqësorë nga Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive.

Gjatë muajit shkurt 2020, Gjykata Administrative, në procedurë për punësim, pa shpallje publike, nëpërmjet marrjes së përhershme, dy nëpunësve gjyqësorë ua ndërpreu marrëdhënien e punës në Gjykatën Administrative për arsye se një bashkëpunëtor i lartë i gjykatës u transferua në Agjencinë e Komunikimeve Elektronike, ndërsa një këshilltar gjyqësor në Institutin e Standardizimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë muajit nëntor 2020, në Gjykatën Administrative, dy nëpunësve gjyqësorë u përfundoi marrëdhënia e punës, edhe atë një këshilltar gjyqësor dhe një bashkëpunëtor të lartë gjyqësor për shkak të përzgjedhjes së tyre si Avokatë Shtetërorë në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë muajit dhjetor 2020, Gjykata Administrative me procedurë të shpalljes së brendshme, e në bazë të pëlqimit të marrë nga Ministria e Financave dhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit 2020, Gjykata Administrative zhvilloi procedurë sipas shpalljes publike për punësimin e nëpunësve gjyqësorë me kohë të caktuar përfundimisht më 31.12.2020.

Në vitin 2020, nevojiten minimum 15 punësime të nëpunësve gjyqësorë: nëpunës gjyqësorë profesionistë, nëpunës administrativë gjyqësorë në zyrën e shkresave dhe daktilografistë, në mënyrë që Gjykata Administrative, në tërësi ta kryejë funksionin e saj në përputhje me rregulloret.

Objekti administrativ (hapësira administrative) në të cilën është vendosur Gjykata Administrative dhe i kryen punët dhe detyrat në

kompetencë të saj, gjendet në rr. "Orce Nikollov" pn. Shkup dhe është pronë e SHA për qarkullim postar "Posta e Maqedonisë" - Shkup dhe të njëjtin, gjykata e përdor në bazë të marrëveshjes për qira të lidhur ndërmjet SHA "Posta e Maqedonisë" - Shkup, si qiradhënës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, si qiramarrës.

Me Vendimin për dhënien në përdorim të përhershëm të gjësendeve të paluajtshme Gjykatës Administrative nr. 44-8928/1 datë 25.9.2018 të sjellë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Gjykatës Administrative i janë dhënë për përdorim të përhershëm, pa kompensim, gjësende të paluajtshme - objekte të cilat gjenden në rrugën "Dame Gruev" nr. 28 në PK nr. 13479 për KK Qendër 1 dhe Fletëpronësia nr. 103028 KK Qendër 1, pronë e Republikës së Maqedonisë. Gjatë vitit 2019, u zhvillua procedurë për përshtatje të brendshme, rinovim dhe rikonstruim të objektit të ri, i cili në përputhje me fushëveprimin e punës dhe kompetencave të Gjykatës Administrative, detyrimisht duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e parashikuara dhe të nevojshme për funksionimin e gjykatës.

Pas dhënies së objektit, nga ana e Gjykatës Administrative, që prej vitit 2018, u zhvillua procedurë për prokurim publik të shërbimit - përgatitje të dokumentacionit projektues, si dhe procedurë për prokurim publik të shërbimit - revizion të dokumentacionit projektues. Projekti për përshtatjen e brendshme me rinovimin e objektit ekzistues - ndërtesës dhe raporti i kontrollit teknik - revizioni i projektit bazë janë përgatitur dhe dorëzuar në Gjykatën Administrative. Pas dorëzimit të projektit të rishikuar, është zhvilluar procedurë për prokurimin e punëve - rinovim me përshtatje të brendshme, për të cilën procedurë janë siguruar mjete në vlerë prej 30,000,000.00 denarë me Aktvendim nr. 01-197/33 datë 31.01.2019 për sigurimin e mjeteve për shpenzime kapitale të përdoruesve individualë të buxhetit për pushtetin gjyqësor për vitin 2019, të miratuar nga Këshilli Gjyqësor Buxhetor. Duke marrë parasysh që oferta më e leverdishme e marrë gjatë procedurës është në vlerë prej 51,682,622.47 denarë, me shkresë të datës 03.06.2019, Gjykata Administrative iu drejtua Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë për të gjetur mënyrë dhe të bëhen përpjekje që të sigurohen mjete për zbatimin e plotë të marrëveshjes kornizë. Nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut njoftuan se ka vullnet për sigurimin e mjeteve për realizimin e plotë të marrëveshjes kornizë, por mjetet do të ndahen në momentin kur do të fillojnë aktivitetet e ndërtimit.

Përkundër të gjitha veprimeve të ndërmarra nga Gjykata Administrative për sigurimin e të gjitha kushteve për rinovimin e objektit dhe sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për rinovimin e objektit, gjykata ende nuk mund ta marrë në zotërim, për arsye se një pjesë e shërbimeve të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve ende e përdorin objektin dhe nuk mund të fillohet me aktivitetet ndërtimore. Gjykata Administrative, me shkresë iu drejtua Avokaturës së Shtetit që të ndërmerr masa konkrete për zhvendosjen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. Përgjigjja e tyre ishte se ministria në fjalë ende nuk është zhvendosur, për arsye se pjesa financiare dhe teknike e procedurës së rikonstruimit dhe mbindërtimit të objektit të ministrisë, i cili ndodhet në rr. "Crvena Skopsko Opshtina" nr. 4, është në fazë përfundimtare dhe se të njëjtët ende nuk kanë leje për shfrytëzimin e objektit. Masa të tjera konkrete nga Avokatura e Shtetit nuk janë ndërmarrë. Me këtë pamundësohet realizimi i punëve ndërtimore profesionale për rinovim dhe përshtatje që janë

të nevojshme, duke pasur parasysh që objekti është ndërtesë e vjetër dhe në masë të madhe i amortizuar.

Me shkresat datë 21.5.2019 dhe 8.8.2019, Gjykata Administrative iu drejtua edhe Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë që të ndërmerren aktivitete përkatëse për tejkalimin e problemit me të cilin përballen. Njëkohësisht, Gjykata Administrative iu drejtua të gjithë institucioneve përkatëse me kërkesë që të ndërmerren masa konkrete për zhvendosjen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe lirim të objektit, përkatësisht të gjendet mënyrë për tejkalimin e situatës së paraqitur, për arsye se, nëse nuk bëhet një gjë e tillë, atëherë seriozisht do të vihej në pikëpyetje zbatimi i Ligjit për Konteste Administrative ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 96, datë 17.5.2019), i cili duhet të fillojë të zbatohet nga data 25 maj 2020.

Për realizimin e Programit do të kujdeset Kryetari i Gjykatës, gjykatësi, nëpunësit gjyqësorë dhe të punësuarit e tjerë në gjykatë.

KRYETARI I GJYKATËS

Brenda fushëveprimit dhe kompetencës funksionale të Kryetarit të gjykatës, janë lëndët nga administrata gjyqësore, edhe atë: "AGJ"; "AGJ -01"; "AGJ -02"; "AGJ -03"; "AGJ -04"; "AGJ -05"; "AGJ -IZZ"; "AGJ -DOV"; "AGJ -STR-DOV"; "UPP" dhe "SPI".

Gjatë vitit 2020, deri në momentin e miratimit të Programit, në regjistrin "AGJ", janë regjistruar 1278 lëndë, në regjistrin "UPP" 470 lëndë, dhe në regjistrin "UPP" 54 lëndë, me ç'rast krahasuar me numrin e kërkesave të regjistruara në regjistrat gjyqësorë të theksuara në periudhën e kaluar, një numër i pritshëm lëndësh të reja në vitin 2021, të cilat do të regjistrohen në regjistrat "AGJ", do të jenë 1500 lëndë, në regjistrin "UPP", 500 lëndë, ndërsa në regjistrin "SPI", 60 lëndë.

Në të njëjtën kohë, Kryetari i Gjykatës Administrative, si gjykatës i kësaj gjykate, nuk vepron dhe nuk vendos për lëndët që do të regjistrohen në Gjykatën Administrative, për paditë që dalin nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, ndërsa duke marrë parasysh detyrimet e Kryetarit të Gjykatës Administrative, në përputhje me Ligjin e Gjykatave, në lidhje me organizimin e punës së gjykatës dhe ndërmarrjen e masave për kryerjen me kohë dhe në mënyrë të rregullt të punës në gjykatë dhe në përputhje me Rregulloren e gjykatës, në lidhje me miratimin e fotografimit, incizimit në gjykatë dhe paraqitjen publike të tyre, e veçanërisht në lidhje me informimin në kohë të publikut për punën e gjykatës gjatë procedurës për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

PUNA NDAJ LËNDËVE

Gjatë periudhës së shënuar në këtë program, puna e Gjykatës Administrative do të kryhet brenda tre seksioneve të specializuara gjyqësore, në përputhje me nenin 12 të Ligjit të Gjykatave ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 58/06; nr. 35 / 2008, 150/10, 83/18 dhe 198/18), edhe atë:

I - SEKSIONI I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR FUSHËN JURIDIKO-PRONËSORE, DENACIONALIZIMIN, URBANIZIMIN, NDËRTIMTARINË DHE PËR TË DREJTAT E TJERA TË NGJASHME

Në kuadër të këtij seksioni, formohet këshill i cili do të veprojë dhe vendosë për lëndët në fushën pronësore-juridike dhe të të drejtave të tjera të ngjashme dhe i njëjti do të vendosë për ndarjen e tokës ndërtimore; tjetërsimin e tokës ndërtimore; regjistrimin në kadastrën e pasurive të patundshme; masat e mbikëqyrjes inspektuese lidhur me marrëdhëniet e punës nga fusha e arsimit; kompensimin për përdorimin e tokës ndërtimore; arsimin; marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore; të drejtën prioritare për përdorimin e tokës ndërtimore; transformimin e së drejtës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore; përcaktimin e përmbajtjes së pasurive të patundshme; regjistrin qendror, mbështetjen financiare për zhvillimin rural, heshtjen e administratës në fushën e mbështetjes financiare për zhvillimin rural, sportin, dëmshpërblimet në bazë të papunësisë, konfliktin e interesit dhe korrupsionin, paditë e tamponëve; shkeljet në fusha të ndryshme; shkarkimin nga funksioni dhe detyra në fushën e seksionit - këshillit; certifikata (licenca) në fushën e seksionit - këshillit; ekspertë në fushën e seksionit - këshillit; subvencionet në fushën e seksionit - këshillit; dhënien e provimit për inspektor në fushën e seksionit - këshillit dhe kontratat administrative në fushën e seksionit - këshillit.

Në kuadër të këtij seksioni, formohen dy këshilla që do të veprojnë dhe vendosin për çështjet në fushën e denacionalizimit, urbanizimit, ndërtimtarisë dhe për të drejtat e tjera të ngjashme dhe ata do të vendosin për denacionalizim; shpronësim dhe baza të tjera administrative; shpronësimin; transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror; shkeljet në zona të ndryshme; shkarkimin nga funksioni dhe detyra në fushën e seksionit - këshillit; shkarkimin nga detyra të organeve të vetëqeverisjes lokale; veterinari; pëlqimin për ekonominë e ujërave; aviacionin; komunikimet elektronike; mjedisin jetësor (në çfarë baze përfshihen mbrojtja dhe shpëtimi nga katastrofat natyrore, subvencione dhe masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor - peleta); ndalimin e ndërtimit; veprimtarinë komunale; legalizimin; transportin në linjë; masat e inspektimit bujqësor; masat e inspektimit, masat e inspektimit në fushën e transportit të linjës; masat e inspektimit në fushën e aprovimit për rikonstruim, ridestitim, përshtatje; masat e inspektimit në fushën e veterinarisë; masat e inspektimit në fushën e veprimtarisë komunale; masat e inspektimit në fushën e mjedisit jetësor; masat e inspektimit në fushën e gjuetisë; masat e inspektimit në fushën e heqjes së ndërtimit, objektit, objektit të përkohshëm; vendim për zgjidhjen e kontratës së qirasë; miratim për kryerjen e veprimtarisë; leje të ndërtimit në trafikut hekurudhor; miratim për rikonstruim, ridestitim, përshtatje; miratim për përdorimin e objektit; heqja e ndërtimit, objektit, objektit të përkohshëm; rimbursimi i subvencioneve; ndërprerja e ndërtimit; radiodifuzion, zgjidhja për kushtet e lokacionit; banimi; peshkimi; masat e sanimit urban; prishja e objektit; pylltari; kthimi i fondeve dhe norma e interesit në fushën e seksionit - këshillit; mbrojtja e monumenteve dhe trashëgimisë kulturore; kulturë (veprimtaria e filmit); ekspertë në fushën e seksionit - këshillit; përdorimi i parkingjeve; shkelje në zona të ndryshme; shkarkime nga funksioni dhe detyra në fushën e seksionit-këshillit; certifikata (licenca) në fushën e seksionit- këshillit; subvencione në

fushën e seksionit- këshillit; dhënia e provimit për inspektor në fushën e seksionit - këshillit dhe kontratat administrative në fushën e seksionit-këshillit.

II - SEKSIONI I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR PENSIONET, TË DREJTAT E SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR, DOGANAT, KONCESIONET, PARTNERITETET PUBLIKO-PRIVATE DHE PËR TË DREJTAT E TJERA TË NGJASHME

Në këtë seksion, formohet këshill i cili do të veprojë dhe vendos për çështjet në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor dhe për të drejtat e tjera të ngjashme dhe i njëjti do të vendosë për shikimin dhe shpërndarjen e fëmijëve; shtesa për fëmijë; baza të tjera administrative, ndihmë të njehershme; pension bujqësor; pension invalidor; shërimi në vend dhe jashtë vendit; invaliditet ushtarak në kohë paqeje; masat mbikëqyrëse të inspektorit të punës; kompensim për pagën me kohë të pjeshme për shkak të kujdesit për fëmijë me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale; rimbursimi i kostove për shërim jashtë vendit; kompensime për barnat e blera dhe pajisjet mjekësore; shumë të ulët të pensionit; shumë të re të pensionit; kompensim monetar për lëndim trupor; ndihmë dhe kujdes për një person tjetër; birësim të fëmijës; ndihmë të përhershme financiare; ndihmë financiare sociale; të drejtat e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor; të drejtat për mbikëqyrje shëndetësore - sanitare; të drejtat e kujdesit shëndetësor; të drejtat për ndihmë financiare për nënën që ka lindur fëmijën e katërt; kontributet e sigurimit pensional dhe invalidor, kontributet e sigurimit shëndetësor; organizatë shëndetësore private; rehabilitimi profesional; shtesa për shurdhim dhe lëvizshmëri; caktim të punëve të tjera përkatëse, rikualifikim, kualifikim shtesë dhe të drejtë për pagesa të tjera; pension familjar; akomodim në qendrën e rehabilitimit për personat me pengesa; ndihmë sociale; pension pleqërie; kujdestari; harmonizim të pensionit; përcaktimi i stazhit të sigurimit - stazhi pensional; shkelje në fusha të ndryshme; shkarkime nga funksioni dhe detyra në fushën e seksionit - këshillit; certifikata (licenca) në fushën e seksionit - këshillit; subvencione në fushën e seksionit - këshillit; dhënia e provimit për inspektor në fushën e seksionit - këshillit dhe kontratat administrative në fushën e seksionit - këshillit.

Në kuadër të këtij seksioni formohet edhe këshill i cili do të veprojë dhe vendos për çështje në fushën e doganave, koncesioneve, partneriteteve publike-private dhe të drejtave të tjera të ngjashme dhe i njëjti do të vendosë për të drejtat e autorit; akcizat; punët bankare; automjetet; shtetësinë; bazat e tjera të menaxhimit, energjetikën; vendbanimet; taksat komunale; koncesionet dhe partneritetet publike-private; evidencën amzë; mbrojtjen; armët; dokumentet e udhëtimit; të drejtat e pronësisë industriale; kundërvajtjet në fushën e doganave; banimin; statusin e refugjatëve-azil; taksën gjyqësore; letrat me vlerë; doganat; subjektet afariste; shqiptimin e sanksioneve; kthimin e fondeve dhe normës së interesit në fushën e seksionit - këshillit; shkeljet në fusha të ndryshme; shkarkime nga funksioni dhe detyra në fushën e seksionit - këshillit; certifikata (licenca) në fushën e seksionit - këshillit; subvencionet në fushën e seksionit - këshillit; dhënia e provimit për inspektor në fushën e seksionit - këshilli dhe kontratat administrative në fushën e seksionit - këshilli.

III - SEKSIONI I SPECIALIZUAR GJYQËSOR PËR ÇËSHTJE FINANCIARE DHE PËR TË DREJTAT E TJERA TË NGJASHME

Në këtë seksion formohen tre këshilla, të cilët do të veprojnë dhe vendosin për çështjet në fushën e tatimit personal; tatimit mbi fitimin; tatimit mbi vlerën e shtuar; tatimit mbi pronën: tatimit të qarkullimit; tatimit mbi trashëgiminë dhe dhuratën; prokurimet publike, verifikimin e fakteve; kandidatë për kursantë në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve; kundërvajtjet në fushën e tatimit; arkëtimin e detyrueshëm (përfshirë edhe arkëtimin e detyrueshëm të taksës së radiodifuzionit dhe arkëtimin e detyrueshëm të taksës së shërbimeve); marrëdhënie pune; çështje financiare nga sporti, të drejtën e pagës pas përfundimit të detyrës, funksionit (apanazhë); financimin e partive politike; kthimin e fondeve dhe normave të interesit, avokatët, ndërmjetësuesit, lojërat e fatit, informacionet e klasifikuar, mbrojtjen e të dhënave personale, shkarkimet nga detyra, ekonomia, përmbaruesit, noterët, qasja në informacion publik, prokurorët (përfundimi dhe shkarkimi i prokurorëve nga funksioni, dhe kandidatët për marrjen e provimit të jurisprudencës), ndihmë juridike falas, ndalimin e kryerjes së veprimtarisë, shkarkim nga funksionet publike, kundërvajtje në fusha të ndryshme; shkarkime nga funksioni dhe detyrë në fushën e seksionit - këshillit (në fushën e financave), certifikata (licenca) në fushën e seksionit - këshillit; subvencione në fushën e seksionit - këshillit; dhënia e provimit për inspektor në fushën e seksionit - këshillit dhe kontratat administrative në fushën e seksionit - këshillit.

Nëse në Gjykatën Administrative paraqitet kontest administrativ, për bazën e cila me këtë program nuk përcaktohet në kompetencat e seksioneve të specializuara, i njëjti do të regjistrohet në Regjistrin-URP-lëndë të ndryshme administrative.

Në Regjistrin-URP-regjistrohen edhe lëndët në bazë "të së drejtës zgjedhore" të lidhura me Kodin Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 40/2006; 136/2008; 148/2008; 155/2008; 163/2008 ; 44/2011; 51/2011; 142/2012; 31/2013; 34/2013; 14/2014; 30/2014; 196/15; 35/16; 97/16; 99/16; 136/16, 142 / 16, 127/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19) si dhe lëndët e regjistruara kundër vendimeve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me Ligjin e Parandalimit të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 12/19), të sjellë në lidhje me nenin 8-a, nenin 8-b dhe nenin 8-c të Kodit Zgjedhor.

Në Regjistrin -URP- regjistrohen rastet në lidhje me Ligjin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/00, 26/01, 13/03, 55/05, 37/06, 115/07, 19/08, 82/08, 10/10, 51/11, 15/13, 139/14, 196/15, 142/16, 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19).

Duke pasur parasysh se gjatë vitit 2020, në këtë gjykatë, gjithsej janë regjistruar dhe formësuar 6842 raste të reja normative, të cilat veprojnë në këshillat brenda seksioneve të specializuara gjyqësore, numri i pritshëm i lëndëve të reja në vitin 2021, do të ishte rreth 7000.

PËRGATITJA E ANALIZAVE, INFORMACIONEVE, SUGJERIMEVE DHE RISHIKIMEVE PËRMBLEDHËSE

Me qëllim përmirësimin cilësisë së punës, në Gjykatën Administrative në vitin 2021, do të përgatiten analiza, informacione dhe sugjerime me rishikime konkrete varësisht nga aktualiteti i çështjeve të caktuara juridike, probleme në punë, ndërsa gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësorë, vitin aktual, sipas nevojës, do të përgatisin materiale për këshillim në një fushë të caktuar, ku në seksionin përkatës do të përcaktohen temat dhe personat që do t'i përgatisin, si dhe koha e mbajtjes së këshillimit. Materiali ndërkaq, do të duhet të verifikohet në seksionin përkatës, gjë për të cilën, kryetarët e këshillave, në kuadër të seksionit, do ta informojnë kryetarin e gjykatës.

Gjatë vitit 2021, do të përgatiten rishikime përmbledhëse dhe informacione për punën e parashtrësive dhe propozimeve në vitin aktual, mbi lëvizjen dhe zgjidhjen e lëndëve në Gjykatën Administrative dhe mbi situatën me zgjidhjen e lëndëve të vjetra.

PRAKTIKA GJYQËSORE

Në kuadër të Gjykatës Administrative funksionon Këshilli i Praktikës Gjyqësore, i cili vepron dhe përpunon përmbajtje të ndryshme që përfshijnë vendime të Gjykatës Administrative, vendime të Gjykatës së Lartë Administrative dhe pjesë nga ato vendime, për çështjet karakteristike që do të ishin të dobishme për gjykatësit gjatë veprimit me lëndët e ardhshme të njëjta ose të ngjashme dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Më pas, në mënyrë të vazhdueshme do të ndiqen të gjitha ndryshimet ligjore, do të ndiqen edhe qëndrimet parimore, mendimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë, që shpallen në Praktikën Gjyqësore, si dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë të rëndësishme për lëndët ndaj të cilave vepron Gjykata Administrative, duke përfshirë edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

LËNDË TË VJETRA DHE ME PRIORITET

Kryetari i Gjykatës Administrative e ndjek punën e gjykatësve, si dhe situatën e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet sistemit AKMIS, si dhe nëpërmjet trupit punues për udhëheqjen e lëndëve.

Trupi punues për udhëheqjen e lëndëve, propozon masa për zgjidhjen e lëndëve të vjetra dhe përgatit plane për zgjidhjen e lëndëve të vjetra. Kryetarët e këshillave do të takohen çdo muaj për të zgjidhur lëndët e vjetra të pazgjidhura.

Gjykatësit të dorëzojnë raport me shkrim për lëndët e vjetra të pazgjidhura, duke përmendur arsyet për moszgjidhjen e tyre dhe të përpilojnë planin e tyre për periudhën kohore në të cilën lëndët do të ishin zgjidhur gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2020, rastet e vjetra të pranuar rishtazi janë 259 ndërsa në vitin 2019 rastet e vjetra të pranuar rishtazi janë 389, që është një rënie prej

33% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Për këtë arsye, në vitin 2020 ka 384 raste të vjetra, ndërsa në vitin 2019, 482 raste të vjetra. Për këtë arsye, në vitin 2020, theks i veçantë do të vihet në uljen e pjesës së mbetur prej 37 lëndëve të vjetra të pazgjdhura që kanë mbetur në fund të vitit 2019, nga të cilat, 19 lëndë janë reregjistruar për shkak të shfuqizimit dhe 5 lëndë për shkak të përsëritjes së procedurës.

TAKIME DHE KËSHILLIME

Me qëllim përsosjen profesionale, gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësorë në Gjykatën Administrative, si dhe të punësuarit e tjerë në shërbimin gjyqësor, do të marrin pjesë në këshillime, seminare dhe trajnime të tjera, të cilat do t'i organizojë Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, gjykatat, Shoqata e Gjykatësve, organet shtetërore dhe organizatat dhe shoqatat e ndryshme të huaja. Më pas, vendimi për të marrë pjesë në këshillime dhe seminare do të merret nga kryetari i gjykatës dhe kryetarët e seksioneve përkatëse, varësisht nga rëndësia e lëndëve që do të jenë temë këshillimi, ndërsa të gjithë kanë të drejtë në përsosje të barabartë profesionale.

FORMA TË TJERA TË PUNËS

Të punësuarit në shërbimin gjyqësor, punën do ta realizojnë brenda detyrave të punës, të parashikuara me aktet e gjykatës dhe ajo që do t'u besohet nga kryetari i gjykatës dhe administratori gjyqësor.

Çdo i punësuar në shërbimin gjyqësor është i detyruar të japë raport mujor mbi punën e tij, në të cilin do ta evidentojë punën e bërë gjatë muajit, e i cili do të përdoret për vlerësimin e punës së tij.

Policia gjyqësore, me të cilën udhëheq kryetari i Gjykatës Administrative, ka për detyrë ta sigurojë ndërtesën e gjykatës, njerëzit dhe lëndët si dhe të trajnohet teorikisht dhe praktikisht, në përputhje me planin e kryetarit të gjykatës.

Gjatë vitit 2021, vazhdimisht do të përditësohen të dhënat në ueb faqen e gjykatës.

Nga data 1.1.2018, në funksion është ueb faqja e brendshme e Gjykatës Administrative, në të cilën publikohen të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me punën e gjykatës.

Gjatë vitit, programi do të plotësohet përkitazi me dukuritë pozitive ose negative të konstatuara, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe të azhurnimit të gjykatës.

*Përkthimin në gjuhën shqipe e organizoi: Bashkëpuntor-përkthyes, Rexhep Ademi

KRYETARI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE
Mr. Burim Sejdini